



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA E LARTË
SEKTORI I PERSONELIT DHE SHËRBIMEVE**

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN
CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE (SPECIALIST/E)**

**Lloji i diplomës “Shkenca juridike”, “Shkenca shoqërore” ose “Shkeca sociale”
Niveli minimal i diplomës “Master Profesional”**

Në zbatim të neneve 9, 56 dhe 57, etj, të ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, Gjykata e Lartë, shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil gjyqësor në Sektorin e Marrëdhënieve me Median, Publikun dhe Bibloteka, për 1 (një) vend të lirë pune, në kategorinë ekzekutive në pozicionet:

- 1 (një) Specialist/e Bibloteke, me kategorinë III-b.

Pozicioni më sipër, u afrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, ato janë të vlefshme për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për

LËVIZJE PARALELE

22 Maj 2020

Afati për dorëzimin e dokumentave për

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

28 Maj 2020

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Specialist/e për Biblotekën është:

1. Administron në përputhje me dispozitat e ligjit “Për Biblotekat në Republikën e Shqipërisë” fondin e biblotekës së Gjykatës së Lartë.
2. Pajis me numrin e mjaftueshëm të kopjeve të ligjeve dhe rregulloreve, komentaret dhe interpretimet e tyre, si dhe të librave dhe periodikëve, të gjithë zyrtarët që u nevojiten në punën e tyre.
3. Regjistron, kartelizon literaturën sipas rregullave që bazohen në standardet e përpunimit bibliotekar-bibliografik.
4. Pasuron fondin e biblotekës me libra dhe literaturë juridike me anë të blerjeve, huazimeve, shkëmbimeve, dhuratave, etj.,
5. Klasifikon librat sipas fushave që i përket, civile, penale, administrative, familjare, kushtetuese, punës, etj, bën sistemimin e tyre duke vendosur skeda, vula, etiketa dhe bën sistemimin me rregull në rafte të veçanta.
6. Organizon punën dhe bën katalogimin e fondit të librave në kompjuter në programin “Pro-Cite”, kryerjen e indeksimit alfabetik i shkrimeve të revistave juridike, mbajtjen e regjistrit dhe pasurimi i tij me hyrje të reja, si dhe zhvillimin e politikës së qarkullimit të librave ndërbibliotekar.
7. Trajton me perparësi kërkesat, kryen detyra si fotokopjime, skanime, etj, për gjyqtarët ndihmesat ligjorë, për Kancelarin dhe për gjithë drejtuesit e sektorëve të tjerë të administratës së institucionit.
8. Librat dhe revistat profesionale të blera, të regjistrohen në mënyrë kronologjike në inventarin e biblotekës. Bën klasifikimin sipas fushave, penale, civile, administrative, kushtetuese, etj, si dhe vendos vulën e gjykatës në çdo libër apo revistë profesionale në qëndër të faqes së parë dhe në disa faqe të tjera.
9. Të komunikojë me publikun sipas orarit dhe rregullave të përcaktuara, në zbatim të standarteve të sjelljes etike në shërbimet me publikun, sipas nevojave dhe detyrave të caktuara nga përgjegjësi i sektorit.
10. Përgjigjet tek përgjegjësi i sektorit për kryerjen e detyrave ditore dhe mban lidhje të vazhdueshme me të, për diskutimin dhe vendimmarrjen në zgjidhjen e problemeve.
11. Kryen detyra të tjera të ndryshme të ngarkuara nga Përgjegjësi i Sektorit dhe Kancelari.

1

LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë gjyqësor të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil gjyqësor.

1.1

KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori.
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët për të dy pozicionet e lartpërmendura duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- d- Të zotërojë një diplomë “Mastër profesional” në studimet e larta universitare, në shkencat juridike, shkencat shoqërore ose sociale. Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
- e- Të ketë të paktën 1 (një) vit eksperiencë pune si specialist.
- f- Përbën avantazh njohja e 2 - 3 gjuhëve të huaja të BE-së.
- g- Të ketë njohuri shumë të mira praktike në përdorimin e kompjuterit.
- h- Të jetë e aftë për të raportuar në kohë detyrat e ngarkuara.
- i- Të plotësojë të gjitha kushtet e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, sipas neneve 9, 55 dhe 56, të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin dhe pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe sipas neneve 20, 21 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësit civil”, i ndryshuar.

1.2

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të plotësojnë pranë Sektorit të Personelit dhe Shërbimeve të Gjykatës së Lartë, dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://dap.gov.al/vende -vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>.
- b- Kërkesë për aplikim.
- c- Fotokopje e diplomës dhe listën e notave (përfshirë edhe diplomën Bachelor).
- d- Fotokopje e librezës së punës (të gjitha faqet që vertetojnë eksperiencën në punë).
- e- Fotokopje e letërnjoftimit (ID).
- f- Vertetimin e gjendjes shëndetësore.
- g- Vertetimin e gjendjes gjyqësore.
- h- Vlerësimet e fundit nga eprori direkt.
- i- Vërtetimin nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi
- j- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
- k- Aktin e deklaramit të statusit si nëpunës civil i kategorisë ekzekutive.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në zyrën e Protokollit, të Gjykatës së Lartë, brenda datës **22 Maj 2020**.

1.3

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIN PARAPRAK

Në datën **25 Maj 2020**, Sektori i Personelit dhe Shërbimeve, do të shpallë në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë, si dhe në tendën e afishimeve të njoftimeve për publikun, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht për shkaqet e moskualifikimit ([nëpërmjet adresës së e-mail](#)).

1.4**FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- b- Ligjin nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikës së Shqipërisë”.
- c- Ligji nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar).
- d- Ligji nr. 9131, datë 15.03.2013 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- e- Duhet të ketë njohuri dhe aftësi për ligjin nr. 8576, datë 03.02.2000 “Për Biblotekat në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar).

1.5**MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv. Totali i pikëve për këtë vlerësim është **40 pikë**.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës.
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme.
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, menyren e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”.

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

1.6**DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë dhe në tendën e afishimeve të njoftimëve për publikun.

2. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurrim nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë dhe në tendën e njoftimit për publikun, duke filluar nga data 01 Qershor 2020.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR DHE KRITERET E VEÇANTA.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët e institucioneve, të cilat janë pjesë e shërbimit civil gjyqësor dhe që plotësojnë kërkesat e përgjithshme të neneve 9, 55 dhe 56, etj, të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe sipas neneve 21 dhe 22, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar).

Kushtet që duhet të plotësojnë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a- Të jetë shtetas shqiptar;
- b- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 98/2016 dhe të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar).

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- g- Të zotërojë një diplomë “Master profesional” në studimet e larta universitare, në shkencat juridike, shkencat shoqërore ose sociale. Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
- h- Të ketë përvojë pune të paktën 1 (një) vit.
- f- Përbën avantazh njohja e 2 - 3 gjuhëve të huaja të BE-së.
- g- Të ketë njohuri të mira praktike në përdorimin e kompjuterit.
- h- Të jetë e aftë për të raportuar në kohë detyrat e ngarkuara.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: [http://dap.gov.al/vende -vakante/udhëzime-dokumenta/219-udhëzime-dokumenta](http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta).
- b- Kërkesë për aplikim.
- e- Fotokopje e diplomës dhe listën e notave (përfshirë edhe diplomën Bachelor).
- d- Fotokopje e librezës së punës (të gjitha faqet që vertetojnë eksperiencën në punë.
- e- Fotokopje e letërnjoftimit (ID).
- f- Vertetimin e gjendjes shëndetësore.
- g- Vertetimin e gjendjes gjyqësore.
- h- Vlerësimet e fundit nga eprori direkt.
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
- j- Vertetimin nga institucioni i fundit ku ka punuar, që nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave më sipër për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive duhet të bëhet brenda datës **28 Maj 2020**.

Në datën **01 Qershor 2020**, Sektori i Personelit dhe Shërbimeve, do të shpallë në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë, në tendën e informimit për publikun, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail ose me celular).

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- a- Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- b- Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.
- c- Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar).
- d- Ligjin Nr. 9131, datë 15.03.2013 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- e- Duhet të ketë njohuri dhe aftësi për ligjin nr. 8576, datë 03.02.2000 “Për Biblotekat në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar).

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës.
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme.
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në **60 pikë**;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në **25 pikë**;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në **15 pikë**;

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.al”.

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhëzime/426-udhëzim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Sektori i Personelit dhe Shërbimeve, pranë Gjykatës së Lartë, do të shpallë fituesin në faqen zyrtare, në tendën e njoftimit për publikun. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, për fazat e mëtejshme të procedurave së pranimit në shërbimin civil të kategorisë ekzekutive:

- Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të Gjykatës së Lartë, si dhe në tendën e njoftimit për publikun, duke filluar nga data **01 Qershor 2020**.

Për sqarime, mund të kontaktoni me numrin e telefonit **04 22 57 308** ose në adresën:
Gjykata e Lartë, Rruga: “Ibrahim Rrugova”, Tiranë

Tiranë me 08.05.2020